

**UDC 316.647.5:2 (497.7) (062) “2001/-”
2-673.5 (497.7) (062) “2001/-”**

Xhemail Çupi, PhD¹

**SUKSESI I KONFERENCAVE NDËRFETARE NË MAQEDONI PREJ 2001 DERI SOT
УСПЕХОТ НА МЕЃУВЕРСКИТЕ КОНФЕРЕНЦИИ ВО МАКЕДОНИЈА ОД 2001 ДО
ДЕНЕС
THE SUCCESS OF INTERRELIGIOUS CONFERENCES IN MACEDONIA FROM 2001
UNTIL NOW**

ABSTRACT

The culmination of dialogue between religious communities is holding interreligious conferences. Until now, five such meetings were held in Macedonia, of which, the first one was at state level and it came as a result of the ethnic war in 2001, initiated by the President of the country and helped by the relevant researchers from the scope of the dialogue; the second one was a regional summit where the leaders of Southeast European countries attended; whereas, the last three conferences were at world level and were supported by Macedonian Government. In this research, it was used the descriptive method, relevant reports and results of a survey of the Institute for Democracy regarding interreligious dialogue were analyzed, whereas the interview was used as a technique. The hypothesis of this research is focused on the success of these conferences regarding population. The results show that despite the fact that these conferences have become part of government programs and the tradition for their organization has already been formed, they have deviated from their essence and initial vision, to be a catalyst of peace in the country and the region.

Key words: The war of 2001, Interreligious conference, religious communities, the Council for interreligious cooperation, , the 2001 Geneva Agreement.

¹ Kandidat për PhD në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, xhemail.c@hotmail.com

HYRJE

Maqedonia, shteti i vetëm që pa luftë u nda prej ish-Jugosllavisë, çdo herë shihej si model i bashkëjetesës mes komuniteteve etnike dhe fetare, sidomos mes dy komuniteteve shumicë, asaj maqedonase ortodokse dhe shqiptare muslimane. Ky iluzion përfundoi në vitin 2001 me luftën e armatosur mes armatës dhe policisë së shtetit që përfaqësohej prej maqedonasve dhe Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare që përfaqësohej prej shqiptarëve të pakënaqur prej sistemit politik në vend. Konflikti mes tyre dita ditës po rritej, situata filloi rëndë të polarizohet dhe ekzistonte mundësi reale për luftë civile. Edhe pse konflikti u zhvillua kryesisht përgjatë vijave etnike, ka pasur të përfshirë edhe elemente të caktuar të tensionit fetar, siç ishte rasti i djegies së xhamive dhe kishave. Kjo luftë i dha kthesë të rrezikshme harmonisë ndëretnike dhe ndërfetare. Si rrjedhojë e kësaj krize, fjala “dialog” ishte epiqendër dhe kryefjalë e çdonjërit të involvuar në sistemin politik në Maqedoni, saqë gati çdo parti politike e futi këtë fjalë në statusit e vet dhe çdo qeveri që vinte në pushtet e deklaronte atë si prioritet, e gjithë kjo, sepse sipas tyre e ardhmja e këtij shteti multietnik dhe multifetar varej totalisht prej tij.

Gjatë shkatërrimit të ish-Jugosllavisë, për fat të keq shumë komunitete religjioze i lejuan vetes që të manipulohen nga të tjerët dhe të fusin më shumë “karburant në zjarrin” e urrejtjes ndëretnike dhe ndërfetare, përderisa disa të tjerë ndjenin se nuk kanë mundësi të japin asnjë kontribut të veçantë në drejtim të paqes. Në këtë periudhë të brishtë politike dhe sociale, Maqedonia ishte e vetmja republikë e ish-Jugosllavisë, udhëheqësit fetar e së cilës, në shpërthimin e luftës së vitit 2001, kërkuan zyrtarisht prej pasuesve të tyre të mos marrin armët kundër njëri-tjetrit dhe njëkohësisht bënë thirrje për zgjidhjen paqësore të konfliktit (Sterland & Beauclerk, 2008, f. 22). Kjo kërkesë u bë me anë të një deklarate apo komunikate të përbashkët të pesë institucioneve të komuniteteve fetare në vend: Kishës Ortodokse Maqedonase, Bashkësisë Fetare Islame, Kishës Katolike, Metodistët e Bashkuar dhe Komunitetit Hebre, takimi u zhvillua në qytetin Morges, të Zvicrës, në qershor 2001 me ndërmjetësimin e Këshillit Evropian të kulteve fetare dhe Këshillit Botëror të kulteve fetare. Por për çudi, kjo komunikatë e përbashkët e pesë institucioneve të

komuniteteve fetare nuk kishte efektin e duhur, pasi lufta filloi të ketë shtrirje edhe më të gjerë në vend, kështu që organizata amerikane “Konferenca Botërore për Religjion dhe Paqe” thirri në vizitë zyrtare në New York udhëheqësit e dy komuniteteve fetare më të mëdha në vend, asaj ortodokse maqedonase në krye me Kryepeshkopin Stefan dhe asaj muslimane në krye me Reis ul Ulema Arif Emini, e gjithë kjo u bë me qëllim që në një të ardhme të afërt në Maqedoni të organizohen takime më të shpeshta të dialogut ndërfaqetar. Por edhe ky takim në New York nuk korri sukses pasi institucionet fetare asnjëherë nuk morën iniciativën të bëjnë takime ndërfaqetare pa prezencën e ndërkombëtarëve dhe si rrjedhojë dyshimet dhe tensionet mes tyre akoma vazhduan të shtohen (Mojzes, 2002).

Presidenti Boris Trajkovski, në një pikë kritike të konfliktit, vizitoi Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në të gjitha takimet zyrtare konstatoi krizën politike në Maqedoni, prandaj kërkoi prej tyre ndihmë në sjelljen e paqes në Republikën e Maqedonisë (Daskalovski, 2004, f. 3). Ai gjatë vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u ftua për të bërë një prezantim në “Institutin Amerikan për Paqe”. Në atë takim, gjatë fjalimit ai kërkoi prej tyre ndihmë në promovimin e dialogut ndërfaqetar si një mjet për ndërtimin e paqes në Maqedoni (Smock, 2006, f. 31). Kjo u realizua përmes profesor Leonard Swidler dhe profesor Paul Mojzes, që ishin udhëheqësit e dialogut ndërkombëtar të dijetarëve dhe redaktorë të revistës të studimeve ekumenike në Filadelfia të SHBA-ve dhe aktivistë të organizatës botërore të “Studimeve të Dialogut Ndërkombëtar vjetor (ISAT)” e krijuar në vitin 1977. Ne kishim privilegjin që të komunikojmë me këta dy studiues në mënyrë elektronike duke zhvilluar një intervistë, por edhe duke u pajisur me literaturë të nevojshme të ndodhive që ata i kanë artikulluar me vite të tëra, si gjatë prezencës së tyre në Maqedoni gjatë krizës së vitit 2001, po edhe gjatë prezencës së tyre në konferencat ndërfaqetare.

Dialogu i vitit 2001 do të mbahet nën patronazhin e Presidentit të Maqedonisë Boris Trajkovski, pasi ky vlerësoi pozitivisht konferencën e ISAT-it të vitit 2000, e mbajtur në Xhakarta të Indonezisë, nën patronazhin e Presidentit Abdurrahman Wahid. (Swidler & Mojzes, 2001, f. 1) Mojzes dhe Swidler vizituan për herë të parë Shkupin në qershor të vitit 2001. Ata gjatë agjendës së tyre u takuan me përfaqësuesit e pesë komuniteteve fetare dhe caktuan datën e konferencës për në nëntor të të njëjtit vit. Me anë të këtij dialogu ata shpresonin në dy pika kryesore: a) përfshirjen e sa më shumë klerikëve në këtë dialog dhe b) organizimin e seminareve ku do merrnin pjesë dijetarë botërorë nga tre religjionet; dhe si rezultat, kur udhëheqësit fetarë në këtë

dialog të shohin vëmendjen ndërkombëtare, ata do pranonin propozimet e këtyre takimeve. Udhëheqësit e komuniteteve fetare fillimisht u distancuan nga ky proces duke thënë se është veprim i nxituar dhe tepër publik në këto kohëra lufte, por e vërteta ishte se të gjithë komunitetet fetare kishin nevojë për asistencë nga ndërkombëtarët për ta kaluar ngërçin e shkaktuar nga politika. Me përkeqësimin e situatës politike dhe ushtarake në vend dialogu ishte i detyruar të shtyhet për më tej, por pas intervenimit të trupave të NATO-s atë vjeshtë, Mojzes dhe Swidler vizituan Shkupin edhe një herë me qëllim që t'i bindin përsëri të gjithë udhëheqësit fetar që të vazhdojnë me dialogun. Në fund u vendos që takimi të bëhet në muajin maj të vitit 2002 (Swidler, 2008, f. 4) me ndihmën financiare të Institutit Amerikan për Paqe dhe Fondacionit për Shoqëri të Hapur. Ata organizuan një konferencë të madhe ndërkombëtare të dialogut hebrej-krishter-musliman në të cilën morën pjesë 50 dijetarë botërorë nga feja hebreje, krishtere dhe islame dhe 150 pjesëmarrës të ftuar nga Maqedonia, duke përfshirë vetë Presidentin e Republikës së Maqedonisë dhe krerët e Kishës Ortodokse Maqedonase, Bashkësisë Fetare Islame, Kishës Katolike, Metodistët e Bashkuar dhe Komunitetit Hebre. Dialogu u titullua "*Ndërtimi i Besimit Ndërmjet kulteve dhe bashkësive fetare në Maqedoni*" (Swidler, 2010). Gjatë bisedës me autorin Swidler kuptuan se cilat ishin metodat e tyre që bindën krerët e komuniteteve fetare të bashkohen në një takim të përbashkët, ai u shpreh: "Ne i bindëm udhëheqësit fetarë të Maqedonisë dhe pjesëmarrësit e tjerë se qasja e dialogimit për ndërtimin e besimit reciprok respektohej jashtë vendit, sidomos në perëndim; ata u ndjenë të nderuar që një tubim i përmasave të këtilla po zhvillohej në vendin e tyre sidomos kur në hapjen dhe mbylljen e konferencës mori pjesë edhe vet Presidenti i shtetit; Ata mendonin se nga një ngjarje e tillë e përmasave të tilla ishte e nevojshme për të dërguar një mesazh për anëtarët e komunitetit të tyre që ishte i përfshirë në luftë".

Takimi kryesor u mbajt në një lokacion neutral, por më tej takimet dhe seminarët u mbajtën në Fakultetin Ortodoks Maqedonas, në Fakultetin e Shkencave Islame, në Universitetin Shën Cirili dhe Metodij, në Universitetin e Tetovës si dhe në lokacione tjera qytetare. Gjatë këtij procesi bisedimesh, krerët e të gjitha komuniteteve fetare, sidomos asaj ortodokse maqedonase në krye me kryepeshkopin Stefan dhe asaj Bashkësisë fetare Islame në krye me Reis ul ulema Arif Emini, pranuan tre sugjerimet e afuara prej pjesëmarrësve të konferencës, më konkretisht: 1) Krijimin e një Këshilli për Bashkëpunim Ndërfetar me pjesëmarrjen e krerëve të pesë institucioneve të komuniteteve fetare në vend; 2) Krerët e institucioneve të komuniteteve fetare,

sidomos asaj Ortodokse Maqedone dhe Bashkësisë Fetare Islame të takohen disa herë në vit për të diskutuar çështje që ndikojnë në raportet e komuniteteve të tyre; dhe 3) studiuesit e këtyre komuniteteve, sidomos mes atyre dy më të mëdha, të shkëmbejnë eksperiencën dhe të ligjërojnë të fakultetet e njëri-tjetrit, pra, të shkëmbejnë eksperiencën akademike.

Gjatë intervistës me ekspertin Paul Mojzes, e pyeta se a ka vazhduar edhe më tej ky këshill, ai më dërgoi një raport që tregonte ecurinë e këtij këshilli brenda viteve. Sipas tij: “Ky këshill për bashkëpunim ndërfaqetarak, në vitet e para pas 2001-shit është takuar disa herë, disa herë me nxitjen tonë, por në shumë raste edhe me dëshirën e vet, por me kalimin e viteve takimet e tyre janë pakësuar, për të mos thënë janë zbehur krejtësisht”. Për mbarëvajtjen e këtyre takimeve dhe seminareve ata kanë pranuar grante nga Instituti për Paqe të Shteteve të Bashkuara, nga Fondacioni Instituti Shoqëri e Hapur si dhe grante të vogla prej shumë organizatave kishtare amerikane (kulteve fetare) (Mojzes, 2004).

Në vijim do paraqesim në pika të shkurtra samitet rajonale dhe konferencat botërore të dialogut ndërfaqetarak të mbajtura në Maqedoni që vijuan pas takimit kulminant të ISAT-it të inicuar prej Presidentit Trajkovski në vitin 2001.

1. Presidenti Trajkovski ishte bërë shumë i interesuar në propozimin e ish-presidentit iranian Ayatollah Mohammed Khatami për të pasur dialog më tepër se një përplasje të qytetërimeve prandaj në vitin 2003 me ndihmën e UNICEF-it organizoi një Samit Rajonal në qytetin e Ohrit të Maqedonisë të titulluar “*Dialogu mes civilizimeve*”. Aty ftoi kryetarët e shteteve të ish-Jugosllavisë që kanë qenë kohët e fundit në luftë me njëri-tjetrin, si dhe presidentët e Shqipërisë, Bullgarisë dhe Hungarisë. Është e mahnitshme se të gjithë presidentët e vendeve kundërshtarë gjatë adresimeve të tyre publike thanë se nëse me kohë do ishte përdorur metoda e dialogut atëherë ndoshta luftërat mund të ishin shmangur (Mojzes, 2007 f. 41). Më shumë se 300 delegatë nga e gjithë bota u kthyen në shtëpitë e tyre me shpresa të reja për faktin se dialogu ndërfaqetarak mund të bënte ndryshime në arritjen e respektit dhe paqes. Ata e përmbyllën konferencën me këtë deklaratë: “Ne hebrenjtë, krishterët dhe muslimanët tani jetojmë në një fshat global ku secili person ballafaqohet me pluralizëm fetarak” (Swidler, 2008, f. 4).

Pas vdekjes tragjike të Presidentit Trajkovski qeveritë pasardhëse të Maqedonisë vendosën që t’i vazhdojnë dhe zgjerojnë edhe më tepër këto dialogje, prandaj me ndihmën e UNESCO-s ata organizuar një sërë konferencash botërore për dialog ndërfaqetarak, me disa qindra pjesëmarrës nga shumë vende dhe religjione të botës, gjegjësisht, në vitin 2007, 2010, dhe 2013, por a janë këto

konferenca me ndikim ashtu siç ishte konferenca e parë e organizuar me kërkesë të presidentit Trajkovski, kjo vlen të analizohet në këtë punim.

2. Konferenca e Parë Botërore e dialogut ndërfaqësor dhe ndërqytetarës u organizua me datë 26-28 tetor të vitit 2007 në Ohër të Maqedonisë. Tema e konferencës ishte *“Kontributi i fesë dhe kulturës në paqe, respekt të ndërsjellë dhe bashkëjetesë.”* Konferenca u sponsorizua nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë me ndihmën financiare dhe logjistike të UNESCO-s. Në konferencë morën pjesë rreth 300 përfaqësues prej të cilëve rreth 200 prej tyre ishin pjesëmarrës të huaj kurse pjesa tjetër e ngelur nga Maqedonia. Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit ishin dijetarë, udhëheqës fetarë dhe figura politike. Ngjarja u mbyll me miratimin e një deklarate të konferencës, ku një draft i kësaj deklarate ishte shkruar paraprakisht dhe e njëjta u propozua para pjesëmarrësve, me çka, ata e diskutuan atë gjerësisht në panelet e tyre. Kjo deklaratë përfshinte konsideratat themelore në lidhje me fenë, kulturat dhe dialogun, por mund të themi lirshëm se shumica e formulimit të saj pasqyrore temat dhe shqetësimet që kishin qenë të diskutuara gjatë konferencës. Kjo ishte një konferencë me rëndësi të posaçme botërore që la te pjesëmarrësit një përshtypje të mirë sa që kur ajo përfundoi, nuk ishte vetëm një konferencë për t’u harruar por një e tillë që të gjitha pjesëmarrësit i shtyri të mendojnë se çfarë mund të bëjnë ata personalisht për të promovuar dialogun ndërfaqësor dhe ndërqytetarës në vendet e tyre.

3. Konferenca e dytë Botërore e dialogut ndërfaqësor dhe ndërqytetarës u zhvillua gjithashtu në Ohër me datë 06-08 maj të vitit 2010, konferenca u titullua *“Religjioni dhe kultura, lidhje e pandashme midis popujve”*. Në këtë konferencë, mosardhja e asnjë përfaqësuesi të Kishës Ortodokse Greke dhe Bullgare dhe të Patrikanës së përgjithshme në Stamboll, dhe dërgimi i vetëm një murgu i quajtur Petar nga dioqeza e Zvornikut – Tuzllës, që konsiderohen si krah i afërt me KOM-in nga Kisha Ortodokse Serbe (mesazhi.com, 2010), ishin shenja të qarta se dialogu ndërfaqësor nuk është duke marrë trajtën e duhur. Sa i takon Bashkësisë Fetare Islame, ajo kushtëzoi pjesëmarrjen në këtë Konferencë në rast se nuk gjendet zgjidhje konkrete për çështjen e xhamisë Burmalit, denacionalizimit të pronës së vakëfit, xhamisë së Prilepit dhe xhamisë në fshatin Llazhec të Manastirit. Ndaj këtij vendimi të BFI-së ka reaguar kryetarja e Komisionit për Marrëdhënie Ndërfetare, Valentina Bozhinovska. Ajo akuzoi BFI-në se po tenton të prishë imazhin e shtetit. (albanian.irib.ir, 2013) por, pas takimeve të zhvilluara të kryetarit të saj, Sulejman Rexhepit me Presidentin Gjorgje Ivanov, kryeministrin Nikolla Gruevski dhe disa ministra, edhe pse nuk mori ndonjë përgjigje të saktë për fatin e këtyre objekteve fetare-islame,

(yllpress.com, 2010) por ju premtua se në të ardhmen e afërt do diskutohet për këtë çështje, ai në fund përsëri pranoi të merr pjesë në Konferencë.

Në aspektin e organizimit, kjo konferencë u konsiderua si vazhdimësi e konferencës së vitit 2007, ajo kishte shumë gjëra të përbashkëta me konferencën paraprake, por gjithashtu kishte edhe disa dallime të theksuara. Pika e parë është se kjo konferencë u organizua nga figurat politike, me shumë pak ndikim në formatin përfundimtar nga anëtarët e komisionit të planifikimit ndërkombëtar, mes tyre Paul Mojzes dhe James R. Payton. Pjesëmarrësit dëgjuan prezantimet nga zyrtarët qeveritar maqedonas (duke përfshirë edhe ministrin e Kulturës, Kryeministrin dhe Presidentin), si dhe fjalimet e udhëheqësit të pesë komuniteteve fetare në Maqedoni, dhe fare në fund, studiuesit dhe udhëheqësit e tjerë fetarë nga e gjithë bota paraqitën punimet e tyre. Gabimi tjetër i kësaj konference në kuptimin e organizimit ishte edhe deklarata “përfundimtare” e konferencës që ishte përgatitur prej në fillim të konferencës. Asnjë punim akoma nuk ishte paraqitur, nuk kishte pasur diskutime akoma, por deklarata ishte “gati për të shkuar.” Kur ai u paraqiti te pjesëmarrësit për “diskutim” në fund të konferencës, modifikimet e sugjeruara nga ata që ishin ende të pranishëm ishin të kota (Mojzes, 2010).

Kurse sa i takon klimës së përgjithshme në Maqedoni në lidhje me dialogun ndërfaqësor, këtë më së miri e paraqet në prezentimin e tij Paul Mojzes, I thirrur në këtë konferencë si anëtar i Asocacionit Krishter për Marrëdhënie me Evropën Lindore, ai shprehet kështu: “Sot përveç që kam ardhur të shpreh mirënjohjet e mia, gjithashtu dua të ndaj edhe shqetësimin tim. Shqetësimi im është se përpjekja për të vazhduar dialogun duket të jetë lënë pas dore. Kam dëgjuar se mbledhjet e Këshillit të Dialogut Ndërfetar mbahen rrallë ose janë ndalur krejtësisht. Është shumë lehtë që komunitetet të vet-izolohen dhe të përqendrohet vetëm në problemet e tyre të brendshme, por këto gabime do ju kthejnë shumë vite pas (2010).”

Gjithashtu është tepër e rëndësishme të theksohet se në cilat gjuhë janë zhvilluar procedurat e konferencave. Në vitin 2007 ajo u shfaq në pesë gjuhë: maqedonase, shqipe, angleze, frënge dhe ruse. Në takimin e “Studiuesve të Dialogut Ndërkombëtar vjetor (ISAT)” të vitit 2002 në Shkup dhe në konferencën e parë botërore të Ohrit të vitit 2007, përkthimi ishte në dispozicion në të dy gjuhët amtare (maqedonase dhe shqiptare), si dhe në gjuhën e pjesëmarrësve nga pjesët tjera të botës. Megjithatë, në Konferencën e Ohrit të vitit 2010 nuk kishte në dispozicion përkthim në gjuhën shqipe. Kjo do konsiderohej si padrejtësi ndaj shqiptarëve, të cilët, në fund të fundit, përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së përgjithshme të Maqedonisë. Kjo ishte

skandaloze, e pashpjegueshme dhe dështim nga ana e planifikuesve të qeverisë, pasi që kjo konferencë kishte për qëllim që të shërbejë jo vetëm komunitetin ndërkombëtar, por para së gjithash popujve të shtetit të tyre. Raportet e gazetave që u shfaqën menjëherë pas hapjes së Konferencës së Ohrit 2010 vunë në dukje se shumica e shqiptarëve kishin braktisur konferencën pas seancës së saj të hapjes, për shkak të këtij neglizhimi të organizatorëve. (Mojzes 2010, f. 43)

4. Konferenca e tretë Botërore e dialogut ndërfeetar dhe ndërqytetëruës u zhvillua gjithashtu në Ohër me datë 10-11 maj të vitit 2013 në Shkup me iniciimin e qeverisë së Maqedonisë. Tema e konferencës ishte *“Liria dhe dinjiteti - vlerat themelore në marrëdhëniet ndërnjerëzore, ndërreligjioze dhe ndërkulturore”*, ndërsa me të do të shënohen tre data të rëndësishme: 1700 vjet nga Edikti i Milanos - fitim i lirisë për krishterizmin; 70 vite nga holokausti i hebrenjve dhe 10 vite nga Samiti i shefave të shteteve nga Evropa Juglindore *“Dialog mes civilizimeve”* e vitit 2003. Ndryshe nga konferencat e mëparshme që nuk morën pjesë kishat e disa shteteve fqinje, por morën pjesë institucionet e pesë komuniteteve fetare në vend, kësaj radhe ajo që refuzoi ftesën ishte Bashkësia fetare Islame e Maqedonisë, ajo vendosi të mos marrë pjesë në konferencë sepse qeveria disa herë radhazi kishte neglizhuar kërkesat e saj. Kjo pakënaqësi e BFI-së është raportuar disa herë edhe në raportin amerikan të lirive fetare në Maqedoni (US Departament of State, 2013 f. 5). Ajo deklaroi se BFI-ja bojkotoi konferencën ndërkombëtare për dialog ndërfeetar të sponsorizuar nga qeveria në muajin maj (2013) për shkak të paragjykimeve të perceptuara nga BFI-ja se qeveria ka mbajtur qëndrime kundër kësaj të fundit, siç janë projektet e saj të rindërtimit dhe pretendimet e kthimit të pronave. Sipas pjesëmarrësit në konferencë, Paul Mojzes, pavarësisht se Bashkësisë Fetare Islame i është bërë padrejtësi, ajo më këtë gjest vetëm ka privuar veten nga një mundësi më tepër për t’u shprehur. Sipas tij, në botën moderne, vendimet për të mos iu bashkuar dialogjeve mund të dëmtojnë ata që mungojnë më shumë se sa ata që marrin pjesë. Si përfundim, ky është një vendim i gabuar sepse ajo pengon muslimanët e Maqedonisë nga prezentimi i ankesave dhe aspiratat e tyre me të tjerët.

Konkludim

Nëse mund të japim një qëndrim në lidhje me ecurit e konferencave të dialogut ndërfeetar dhe ndërcivilizues mund të themi se pavarësisht se këto konferenca janë bërë pjesë e programeve qeveritare dhe tashmë është formuar një traditë për organizimin e tyre, ato kanë devijuar prej

esencës së tyre dhe prej vizionit fillestar, që të jenë një katalizator i paqes në vend dhe rajon. Ky devijim ka nisur pas konferencës së vitit 2007. Sot, Këshilli i Bashkëpunimit Ndërfetar mund të konsiderohet "i çalë." Të gjitha bashkësitë fetare, përveç Kishës Ortodokse Maqedonase, kanë dërguar zyrtarisht letër te njëri-tjetri. Një nga arsyet se pse Kisha Ortodokse Maqedonase nuk është treguar shumë aktive në korrespondencën ndërfetare dhe ka marginalizuar këtë çështje si dytësore është se konflikti i Kishës Ortodokse Maqedonase me Kishën Ortodokse Serbe mbi të drejtën e autoqefalisë duket se ka konsumuar shumë energjitë e institucionit fetar maqedonas. Kjo e fundit është gjithashtu shumë e acaruar kur gjatë negociatave për t'i dhënë fund luftës së 2001-shit me Marrëveshjen e Ohrit, amendamentet e votuara në Parlamentin e Maqedonisë që pësuan me ndryshime kushtetuese, ia privuan privilegjin e të qenurit i vetmi institucion fetar i përmendur në kushtetutë, duke e bërë atë të jetë tashmë gati të barabartë me komunitetet e tjera fetare në vend.

Sot, Këshilli për Bashkëpunim Ndërfetar, kur udhëheqësit e huaj nuk janë të pranishëm, rrallë takohet. Individualisht përfaqësuesit e komuniteteve fetare kanë pranuar të punojnë me njëri-tjetrin me mbështetjen e fondeve ndërkombëtare (USIP), por ritmi i bashkëpunimit të tyre është dukshëm i ndryshëm nga ajo që ndërkombëtarët e dëshirojnë (Mojzes 2006).

Se sa rezultues kanë qenë këta dialogje dhe konferenca ndërfetare, mund të peshohet edhe me faktin se sa besim ka në mes komuniteteve fetare në njërin anë dhe komuniteteve fetare dhe qeverisë në anën tjetër. Këtu e shohim të arsyeshme të inkuadrojmë një anketim (idses.org.mk, 2009) të vitit 2011 i zhvilluar prej Fondacionit "Konrad Adenauer", dhe Institutit për demokraci "Societe Civil". Anketimi ishte pjesë e projekti të titulluar "*Tolerancë, dialog dhe bashkëpunim*". Anketimi kishte mostër të rastësishme. Madhësia e mostrës dallon prej 1050 deri 1600 të intervistuar në pajtim me lëndën e hulumtimit. Gjatë përcaktimit merren parasysh specifikat socio-demografike (gjinia, struktura e moshës, arsimit, struktura socio-ekonomike dhe përkatësia etnike/fetare dhe vendbanimi) i popullatës së interesit me margjina gabimi prej 3% ndërsa mostra prej 1600 të intervistuar, margjina e gabimit mund të jetë prej 2.5%.

Ne këtu do elaborojmë vetëm disa prej pyetjeve që janë parashtruar në këtë anketë që kanë të bëjmë drejtpërsëdrejti me dialogun ndërfetar në Maqedoni 14 vite pas luftës së vitit 2001. Mes tyre veçojmë:

Pyetja e 24 thotë: *Në çfarë mase pajtoheni me qëndrimin në vijim: "Në Maqedoni ekziston tolerancë ndërfetare midis popullit"*. Rezultatet tregojnë se pjesa më e madhe e të intervistuarve

ose 40.1% pjesërisht pajtohen me qëndrimin se në Maqedoni ekziston tolerancë ndërfitare mes popullit (prej tyre 26% janë ortodoks maqedonas dhe 9.9% janë muslimanë); 21.7% pjesërisht nuk pajtohen me këtë qëndrim (prej tyre 15.6% janë ortodoks maqedonas dhe 4.6% janë muslimanë); 21% plotësisht pajtohen (prej tyre 15% janë ortodoks maqedonas dhe 5% janë muslimanë); 15.6% fare nuk pajtohen (prej tyre 8.7% janë ortodoks maqedonas dhe 6.1% janë muslimanë) dhe 1.7% nuk e dinë përgjigjen (prej tyre 1.2% janë ortodoks maqedonas dhe 0.4% janë muslimanë). Me këtë mund të konkludojmë se ekziston ndarje mes të intervistuarve në lidhje me atë se a janë plotësisht dakord ose pjesërisht nuk pajtohen. Për këtë qëndrim nuk ka dallim të madh mes përfaqësuesve të religjioneve të ndryshme në Maqedoni, sidomos mes asaj ortodokse dhe muslimane.

Pyetja 32 thotë: *“Sipas jush, a ekziston ndonjë faktor i cili në mënyrë negative ndikon mbi tolerancën ndërfitare në vend?”* Rezultatet tregojnë se 54.1% e të anketuarve mendojnë se ekziston ndonjë faktor që ndikon mbi tolerancën ndërfitare në vend (prej tyre 31.8% janë ortodoks maqedonas dhe 17.4% janë muslimanë); 38.4% thonë se nuk ekziston ndonjë faktor që ndikon mbi tolerancën ndërfitare në vend (prej tyre 28.8% janë ortodoks maqedonas dhe 7.7% janë muslimanë); dhe 7.4% nuk e dinë përgjigjen (prej tyre 5.9% janë ortodoks maqedonas dhe 0.9% janë muslimanë). Me këtë konkludojnë se: perceptim i shumicës nga të intervistuarit është se në Maqedoni ekziston faktor i cili negativisht ndikon mbi tolerancën ndërfitare në vend, ndërsa një pakicë e vogël konsideron që një faktor i tillë nuk ekziston. Përfaqësuesit e idesë që ekziston, në përqindje të madhe janë muslimanët për dallim nga religjionet tjera.

Pyetja e 33 është vazhdimësi e pyetjes paraprake dhe thotë: *“Nëse po, cili është ai faktor?”*. Rezultatet tregojnë se 38.8% e të anketuarve mendojnë se janë “politikanët” (prej tyre 22.7% janë ortodoks maqedonas dhe 14.6% janë muslimanë); 18.6% mendojnë se është “Qeveria” (prej tyre 4.2% janë ortodoks maqedonas dhe 9% janë muslimanë); 18.3% mendojnë se janë “bashkësitë fetare” (prej tyre 13.9% janë ortodoks maqedonas dhe 3.2% janë muslimanë); 8% mendojnë se janë “të huajt” (prej tyre 4.1% janë ortodoks maqedonas dhe 3.4% janë muslimanë); 1.5% mendojnë se janë “tjerët” (prej tyre 1.4% janë ortodoks maqedonas dhe 0.2% janë muslimanë); dhe 1% e të anketuarve nuk e dinë përgjigjen (prej tyre 0.8% janë ortodoks maqedonas dhe 0.2% janë muslimanë). Me këtë mund të konkludojmë se politikanët janë faktori që ndikon negativisht në tolerancën ndërfitare sipas numrit më të madh të intervistuarve (38,8). Si faktor i dytë i radhitur janë me 18% Qeveria dhe komunitetet fetare ndërsa të tretë janë

mediat. Politikanët dhe Qeveria janë dy përgjigjet më të shpeshta që janë treguar në grupin e të anketuarve myslimanë. Komunitetet fetare dhe mediat janë faktori më i madh negativ për krishterët ortodoks në Maqedoni.

Pyetja 34 thotë: *“Sipas jush, a ekziston bashkëpunim midis bashkësive fetare në nivelin më të lartë në Maqedoni?”*. Rezultatet tregojnë se 37.3% e të intervistuarve mendojnë se ka pak bashkëpunim (prej tyre 24.9% janë ortodoks maqedonas dhe 8.2% janë muslimanë), 25% mendojnë se ka bashkëpunim mes komuniteteve fetare (prej tyre 19.4% janë ortodoks maqedonas dhe 4.5% janë muslimanë), 19.4% mendojnë se nuk ka bashkëpunim mes tyre (prej tyre 12.4% janë ortodoks maqedonas dhe 6.6% janë muslimanë), 9.4% mendojnë se nuk ka fare bashkëpunim (prej tyre 4.6% janë ortodoks maqedonas dhe 4% janë muslimanë) dhe 8.8% nuk e dinë a ka bashkëpunim (prej tyre 5.3% janë ortodoks maqedonas dhe 2.8% janë muslimanë). Si konkludim mund të themi se ekzistenca e bashkëpunimit mes komuniteteve fetare në nivelin më të lartë është një qëndrim i përbashkët për më tepër se gjysma e të intervistuarve, ndërsa sipas një pakice të vogël në Maqedoni nuk ekziston bashkëpunim mes këtyre dy komuniteteve në nivelin më të lartë. Kur bëhet krahasim i përgjigjeve pas kësaj pyetje, mund të vërehet që ortodoksët në pjesën më të madhe për dallim nga tjerët mendojnë se bashkëpunimi ekziston.

Pyetja 35 dhe e fundit thotë: *“Sipas jush, a ka bashkëpunim midis bashkësive fetare në nivelin lokal në Maqedoni?”* Rezultatet tregojnë se 36.5% e të anketuarve mendojnë “Po, ka pak bashkëpunim” (prej tyre 24.7% janë ortodoks maqedonas dhe 8.6% janë muslimanë); 21.9% mendojnë “Po, ka bashkëpunim” (prej tyre 16.7% janë ortodoks maqedonas dhe 4.2% janë musliman); 20.3% mendojnë se nuk ka bashkëpunim (prej tyre 12.3% janë ortodoks maqedonas dhe 5.9% janë muslimanë); 11% mendojnë se nuk ka fare bashkëpunim (prej tyre 6.4% janë ortodoks maqedonas dhe 4% janë muslimanë); dhe 10.3% e anketuarve nuk e dinë përgjigjen (prej tyre 6.4% janë ortodoks maqedonas dhe 3.3% janë muslimanë). Më këtë mund të konkludojmë se sipas më tepër se gjysma e gjithë të intervistuarve mes komunitete fetare në nivelin lokal në Maqedoni ekziston bashkëpunim, ndërsa pjesa tjetër prej 31,3% mendojnë që komunitetet fetare nuk bashkëpunojnë mes vete. Ajo që mund të vërehet është që ka përputhje mes qëndrimeve në lidhje me bashkëpunimin në nivel më të lartë dhe nivel lokal. Sërish, edhe këtu krishterët ortodoks dallohen si përfaqësues të qëndrimit se bashkëpunimi ekziston.

Rekomandime dhe rezime

Në fund, që në të ardhmen të mos keni përsëri regres në dialogun ndërfaqetor, rekomandojmë dy rrugë që janë potencialisht të dobishëm në zgjerimin e dialogut ndërfaqetor me burime relativisht modeste. E para do ishte takime ndërfaqetore të gjinisë femërore në nivele lokale apo mes qytetesh, dhe e dyta, krijimi i aktiviteteve ndërfaqetore rinore, të tilla si kampe udhëtime, ekskursionet apo ndoshta projekte të përbashkëta humanitare për të pastrehët. Përvoja ka treguar se ndonjëherë gratë dhe të rinjtë me më shumë entuziazëm ndërveprojnë me njëri-tjetrin përtej kufijve fetar dhe etnik sesa udhëheqësit të rritur meshkuj të cilët shpesh të ndikuar prej pozicioneve të tyre hierarkike, prej linjave tradicionale të demarkacionit dhe strukturave të pushtetit janë tepër armiqësor, konspirativë dhe pasiv.

Pavarshisht se këto konferenca janë bërë pjesë e programeve qeveritare dhe tashmë është formuar një traditë për organizimin e tyre, ato kanë devijuar prej esencës së tyre dhe prej vizionit fillestar, që të jenë një katalizator i paqes në vend dhe rajon, kjo filloi prej në momentin kur politikanët nisën të manaxhojnë mbarvajtjen e konferencave ndërfaqetore dhe ndërcivilizuese.

Rekomandojmë që gjatë konferencave të ardhëshme, si ajo që pritet në vitin 2016, fokusi të përqëndrohet në të ardhmen dhe jo në të kaluarën dhe në historinë e konflikteve mes komuniteteve, të punojmë së bashku në drejtim të shmangies së luftës civile që ishte në greminë në vitin 2001, drejt një tolerance më të madhe ndër-etnike dhe ndër-fetare.

Pavarshisht faktit se dialogu ndërfaqetor shihet me dyshim të madh në Maqedoni, megjithatë, nëse kryhen në frymën e barazisë dhe të drejtësisë, ajo është e aftë, që të çojë në një rritje të besimit mes komuniteteve.

Resume:

Despite the fact that these conferences have become part of government programs and the tradition for their organization has already been formed, they have deviated from their essence and initial vision, to be a catalyst of peace in the country and the region, it started from the moment when when politicians began to manage the progress of the inter-faith and inter-civilisation conferences.

We recommend that during the next conference, as it is expected in 2016, the focus must be concentrated on the future and not on the past and on the history of conflicts between

communities, we must work together in terms of avoiding civil war who was on the precipice in 2001 towards a greater inter-ethnic and inter-religious tolerance.

Despite the fact that interfaith dialogue is seen with great suspicion in Macedonia, however, if carried out in the spirit of equality and justice, it is able, to lead to an increase of confidence between communities.

Bibliografia:

- Daskalovski, Z. (2004). *The macedonian conflict of 2001: between successful diplomacy, rhetoric and terror*.
- Mojzes, P. (2001). The Role of Religious Leaders in Times of Conflict in Multinational and Multireligious Societies - A Contribution Toward Interreligious Dialogue in Macedonia. *Occasional Papers on Religion in Eastern Europe*, XXI(6).
- Mojzes, P. (2002). From Crisis to Post-crisis in Macedonia. *Occasional Papers on Religion in Eastern Europe*, XXII(4).
- Mojzes, P. (2004). The Role of Religious Leaders in Times of Conflict in Multinational and Multireligious Societies: a Contribution Towards Interreligious Dialogue in Macedonia. *Dialogue among Civilizations, Regional Summit on Inter-religious and Inter-ethnic Dialogue*, (p. 135). Tirana.
- Mojzes, P. (2006). "Peacemaking through Interreligious Dialogue in Macedonia" in *Religious Contributions to Peacemaking: When Religion Brings Peace, Not War*. (D. R. Smock, Ed.) Washington D.C.: United States Institute for Peace,.
- Mojzes, P. (2007). Orthodoxy and Islam in the Balkans: Conflict or Cooperation? Vienna, Austria.
- Mojzes, P. (2007). Tensions within Religious Communities in the Balkans. *Occasional Papers on Religion in Eastern Europe*, XXVII(4).
- Mojzes, P. (2010). Ohrid 2010: The Second World Conference on Inter-Religious and Inter-Civilization Dialogue. *Occasional Papers on Religion in Eastern Europe*, XXX(4), 39-45.
- Mojzes, P. (2014). From genocide to dialog christian-muslima relations in former Yugoslavia. (XXXIV, Ed.) *Occasional Papers on Religion in Eastern Europe, Christians Associated for Relations with Eastern Europe*.
- Pettifer, J. (2001). *Former Yugoslav Macedonia - The Shades of Night?* Conflict Studies Research Centre.
- Smock, D. (2006). *Religious Contributions to Peacemaking, When Religion Brings Peace not war*. Washington, DC: Peaceworks.
- Sterland, B., & Beauclerk, J. (2008). *Faith Communities as Potential Agents for Peace Building in the Balkans - An analysis of faith-based interventions towards conflict transformation and lasting reconciliation in post-conflict countries of former Yugoslavia*. Oslo: Norwegian Church Aid.
- Swidler, L. (2008). Can interreligious dialogue make a difference? *Journal of Ecumenical Studies*, XLIII(2), 4.
- Swidler, L. (2010). Trialogue: out of the shadows into blazing "desert" SUN. *Journal of Ecumenical Studies*, XLIII(3), 502-506.
- Swidler, L., & Mojzes, P. (2001). Nurturing a Culture of Dialogue - Report of the Visit to Skopje, Macedonia. *Occasional Papers on Religion in Eastern Europe*, XXI(4).
- albanian.irib.ir. (2013, May 11). Retrieved May 19, 2015, from albanian.irib.ir:
<http://albanian.irib.ir/component/k2/item/132395-konferenca-nd%C3%ABrfetare,-bfi-e-bojkoton>
- yllpress.com. (2010, April 15). *www.yllpress.com*. Retrieved May 19, 2015, from *www.yllpress.com*:
<http://www.yllpress.com/9765/bfi-kushtezon-pjesemarrjen-ne-konferencen-per-dialog-nderfetar.html>
- mesazhi.com (2010) *www.mesazhi.com*, [Online], Available:
<http://www.mesazhi.com/mendime/neoher-filloi-konferenca-per-dialog-nderfetar-dhe-ndercivilizues> [29 september 2014].
- US department of state (2013) <http://www.state.gov>, [Online], Available:
<http://www.state.gov/j/drl/rls/irf/religiousfreedom/index.htm#wrapper> [30 Sep 2014].